



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 786/1 Prot.

Tiranë, më 23 / 05 / 2019

**V E N D I M**

**Nr. 63, Datë 23 / 05 / 2019**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 26, datë 25.03.2019, të bërë nga I.Xh kundër Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qytetit Tiranë (DAR Tiranë), Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) dhe Drejtorisë Rajonale të Punësimit Tiranë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar<sup>1</sup>”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: *“Në vitin 1993 ka pësuar një aksident me makinë. Në vitin 2000-2001 është diplomuar si mësues i edukimit fizik në Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi”<sup>2</sup>. I është drejtuar MASR dhe DAR-it Tiranë Qytet për të kërkuar punë, bazuar në nenin 15<sup>3</sup> të Ligjit nr.7995, datë 20.09.1995 “Për nxitjen e punësimit” i ndryshuar, por nuk ka gjetur zgjidhje. Në Gusht 2018 i është drejtuar për punë si mësues i edukimit fizik, DAR-it Tiranë, por i janë përgjigjur se nuk ka vende pune. Në Qershor 2018 i është drejtuar zyrës së punës, por i janë përgjigjur se do ta njoftojnë kur të ketë vende pune, por deri më sot nuk ka marrë përgjigje”.*

<sup>1</sup> Referuar, Librezë Antarësie nr.1 të vitit 2019, lëshuar nga Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar.

<sup>2</sup> Referuar Diplomës nr. 914, datë 05.07.2001, nr. Rreg. 3216.

<sup>3</sup> Neni 15/1: “Çdo punëdhënës që punëson më tepër se 24 punonjës, është i detyruar të punësojë një person me aftësi të kufizuar për çdo 25 punonjës të personelit të tij”.

• Ligji nr.7995, datë 20.09.1995 “Për nxitjen e punësimit” i ndryshuar, është shfuqizuar me ligjin nr.15, datë 13.03.2019 “Për nxitjen e punësimit”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, zbatimin e ligjit nr. 7995/1995 “Për nxitjen e punësimit” dhe mundësimin për të filluar punë.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së<sup>4</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 26, datë 25.03.2019 të I.Xh u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 450/1, datë 01.04.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga, MASR, DAR Tiranë dhe Drejtorisë Rajonale të Punësimit Tiranë për ankesën e bërë nga I.Xh.
- Me shkresën nr. 450/2, datë 01.04.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga subjekti ankues, kopje të kërkesave për punësim të dërguara pranë DAR

<sup>4</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Tiranë, MASR, Zyrës së Punës Tiranë, kopje të raportit të KMCAAP dhe Diplomës së arsimit të lartë.

Në datë 17.04.2019, subjekti ankues është paraqitur pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ka shpjeguar<sup>5</sup> se: *“Në fund të muajit Gusht 2018 ka takuar Drejtoreshën e DAR Tiranë të cilës i ka kërkuar që të punësohet si mësues i edukimit fizik dhe ka marrë përgjigje me gojë se nuk ka vende pune të lira për mësues. Ankuesi informoi se nuk ka dorëzuar dokumentet për të kërkuar vend pune si mësues në portalin “Mësues për Shqipërinë”. Gjithashtu, ankuesi informoi se nuk ka bërë kërkesë me shkrim në MASR, por në një takim informal me Ministren e Arsimit, ka marrë përgjigje se nuk ka vende pune për mësues të edukimit fizik”.*

Lidhur me pretendimin kundër Zyrës së Punës Tiranë, subjekti ankues deklaroi se: *“Nuk ka ankesë kundër zyrës së punës, pasi ka kërkuar që të punësohet dhe i kanë ofruar punë sipas profesioneve që kanë pasur në dispozicion”.* Referuar deklaratës së mësipërme, Komisioneri nuk do shqyrtojë pretendimin e ankuesit kundër Zyrës së Punës Tiranë, pasi ankuesi ka hequr dorë nga pretendimi.

Me shkresën nr. 67/1, datë 06.02.2018, DAR Tiranë në mes të tjerash informoi se: *“Në nenin 60/1 të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH” i ndryshuar, përcaktohet se: “Në institucionin arsimor publik, përfshirë dhe atë parashkollor, pranimit dhe emërimi i mësuesit në një vend pune mbështetet në parimin e meritës dhe të drejtën për zgjedhjen e institucionit arsimor. Emërimi i mësuesit bëhet nga drejtori i institucionit arsimor, sipas renditjes në portalin “Mësues për Shqipërinë””. Në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr.38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar” si dhe në Udhëzimin nr.12, datë 27.02.2018 “Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar” sqarohet e gjithë procedura që duhet të ndiqet për të qenë pjesë e portalit “Mësues për Shqipërinë”, dokumentacioni i duhur për aplikim si dhe mënyra e realizimit të testimit të kandidatëve. Në bazë të këtyre akteve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, të gjithë personat që duan të aktivizohen si mësues, duhet t’i nënshtrohen procesit të konkurimit (testimit) “Mësues për Shqipërinë”, pas dorëzimit të dokumentacionit përkatës (faza e parë) dhe testimit të informatizuar (faza e dytë), sipas procedurave dhe njoftimeve të bëra në lidhje me këtë proces. Që prej vitit 2014, kur ka filluar edhe aplikimi i portalit “Mësues për Shqipërinë”, I.Xh nuk ka aplikuar dhe nuk ka qenë asnjëherë pjesë e portalit, ç’ka do të bënte të mundur dhe punësimin e tij si mësues në institucionet arsimore publike të qytetit të Tiranës”.*

Me shkresën nr. 3732/1, datë 15.04.2019, Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë në mes të tjerash informoi se: *“Punësimi i mësuesve në institucionet arsimore rregullohet me ligjin nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH” i ndryshuar, Udhëzimin nr.38, datë 06.10.2015*

<sup>5</sup> Referuar procesverbalit datë 17.04.2019.

*“Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar” si dhe me Udhëzimin nr.12, datë 27.02.2018 “Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”. Nga DAR Tiranë jemi informuar se që prej vitit 2014, kur ka filluar edhe punësimi i mësuesve nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”, I.Xh nuk ka aplikuar dhe nuk ka qenë asnjëherë pjesë e portalit, që do të krijonte mundësinë për punësimin e tij. Si rrjedhojë, pretendimi i I.Xh se është diskriminuar nga ana e DAR Tiranë, për shkak të “aftësisë së kufizuar”, nuk qëndron”.*

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm të ankuesit nga DAR Tiranë dhe MASR.**

Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 108/2012, datë 15.11.2012, ka për qëllim të nxisë, të mbrojtë dhe të sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre. Parimi i mosdiskriminimit është një ndër parimet kryesore të kësaj Konvente. Në kuptim të kësaj Konvente, personat me aftësi të kufizuar përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë<sup>6</sup>.

Shqipëria e ka formalizuar vullnetin e vet për zbatimin e këtyre detyrimeve në fushën e punësimit, përmes miratimit të ligjit nr.15, datë 13.03.2019 “Për nxitjen e punësimit” i cili në nenin 20/1/a, përcakton se: Punësimi i personave nga grupet e veçanta; *“1. Çdo punëdhënës duhet të punësojë: a) një person që i përket grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja “c”<sup>7</sup>, të këtij ligji, për 25 punonjësit e parë të ndërrmarrjes”.*

Në nenin 60/1 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH” i ndryshuar, përcaktohet se: *“Në institucionin arsimor publik, përfshirë dhe atë parashkollor, pranimit dhe emërimi i mësuesit në një vend të lirë pune mbështetet në parimin e meritës dhe të drejtën për zgjedhjen e institucionit arsimor. Emërimi i mësuesit bëhet nga drejtori i institucionit arsimor, sipas renditjes në portalin “Mësues për Shqipërinë”. Procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune, si dhe administrimi i portalit “Mësues për Shqipërinë” përcaktohen me udhëzim të ministrit”.*

<sup>6</sup> Konventa mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuar dhe Protokollin Opsional, Neni 1.

<sup>7</sup> Neni 3/4/c: “Persona me aftësi të kufizuara, përfshirë personat që nuk dëgjojnë dhe invalidët e punës të vlerësuar pjesërisht të aftë për punë nga komisionet përkatëse”.

Në Kreun 1, pika 4 të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar” përcaktohet se: *“Kandidatët e interesuar për të ushtruar profesionin e mësuesit marrin pjesë në konkurim, i cili zhvillohet në tri faza: A. Konkurrim me dosje. B. Konkurrim nëpërmjet testimit “Mësues për Shqipërinë”. C. Zgjedhja e vendit të punës”*. Ndërsa në Kreun 4, pika 4 dhe 9 “Procedura e zgjedhjes së vendit të punës dhe emërimi i mësuesit” të këtij udhëzimi përcaktohet se: *“4. Kandidati emërohet nga drejtori i institucionit arsimor me kontratë individuale pune me afat një vit kalendarik (periudhë prove). Kontrata nënshkruhet ndërmjet mësuesit dhe drejtorit të institucionit arsimor”* ndërsa në pikën 9 përcaktohet se: *“Për vendet e lira me ngarkesë mësimore të pjesshme apo të përkohshme, lidhet kontratë e përkohshme pune ndërmjet drejtuesit të institucionit arsimor dhe kandidatit. Kandidati i punësuar sipas kësaj pike, nuk e humbet të drejtën për t’u njoftuar për të zgjedhur, sipas këtij kreu, si dhe ka të drejtën e ndërprerjes së njëanshme të kontratës përpara afatit”*.

**Referuar legjislacionit të sipërcituar dhe procedurave të kërkuara, arrihet në përfundimin se për t’u punësuar si mësues me ngarkesë të plotë apo të pjesshme, të përkohshme apo të përhershme në institucionet e arsimit parauniversitar duhet të respektohen procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”, i ndryshuar dhe në Udhëzimin nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”.**

Referuar dokumentacionit të administruar dhe deklaratave të I.Xh, rezulton se subjekti ankues nuk ka aplikuar asnjëherë pranë DAR Tiranë për tu punësuar si mësues i edukimit fizik.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimi e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Bazuar në përgjigjen shkresore të dërguar nga MASR, DAR Tiranë dhe deklaratës së I.Xh, vlerësojmë se subjekti ankues nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë apo të pafavorshëm nga sa parashikohet në ligjin 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në

RSH” i ndryshuar, dhe udhëzimet përkatëse për punësimin si mësues në institucionet publike të arsimit parauniversitar, pasi jemi në situatën kur subjekti ankues nuk ka ndjekur procedurën për t’u punësuar si mësues i edukimit fizik.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 7/1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri vlerëson se DAR Tiranë dhe MASR, nuk kanë ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj I.Xh, ose që e kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi të padrejtë, për shkak të aftësisë së kufizuar, pasi ankuesi nuk arriti të provonte se kishte aplikuar për t’u punësuar si mësues pranë DAR-it Tiranë.

**Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i rekomandon subjektit ankues, që nëse kërkon të punësohet si mësues i edukimit fizik, të ndjekë procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”, i ndryshuar dhe në Udhëzimin nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”.**

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të I.Xh nga ana e Drejtorisë Arsimore Rajonale, Tiranë Qytet dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për shkak të aftësisë së kufizuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**Robert GAJDA**

**KOMISIONER**